LIGJ
Nr. 55/2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008, "PËR TAKSAT KOMBËTARE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e deputetit Ilir Beqaj,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 4, "Niveli i taksave kombëtare" bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 8, pas fjalisë së parë, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Në rastet kur artikujt që importohen në kapitullin 39, të NKM-së, pjesa joplastike zë më shumë se 51 për qind të masës së përgjithshme, kjo taksë zbatohet vetëm për pjesën e masës së plastikës.".

2. Në pikën 8/1, fjalët: "25 lekë/kg", zëvendësohen me fjalët: "10 lekë/kg".

3. Pika 8.5, riformulohet si më poshtë:

"8.5 Për ambalazhet plastike/qelqi, lëndët e para, si dhe për materialet/artikujt prej plastike, të cilat eksportohen dhe për të cilat taksa është paguar në momentin e importit/prodhimit të tyre, administrata doganore rimburson shumën e taksës së paguar. Rimbursimi bëhet sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.".

Neni 2

Në nenin 9, "Përjashtime nga pagimi i taksave kombëtare", në pikën 4, pas shkronjës "d", shtohen shkronjat "dh", "e", "ë" dhe "f", me këtë përmbajtje:

"dh) lëndët e para në forma primare apo artikujt e tjerë të importuar dhe që klasifikohen në kapitullin 39, të NKM-së, të cilat përdoren si plotësues teknologjik, lëndë të para aditive (agregate lidhëse), apo si material për prodhimin e produkteve që nuk kategorizohen si artikuj plastikë. Taksa për lëndët e para në forma primare apo artikujt e tjerë të importuar do të aplikohet vetëm nëse materialet/artikujt e prodhuar nga këto lëndë të para janë subjekt i llogaritjes së taksës në rast se këto materiale/artikuj do të importohen;

e) lëndët e para në forma primare për prodhimin e polisterolit (*EPS expanded polysterene*), importimi i paneleve, pllakave të polistirenit (*XPS extruder polystyrene*), si dhe profileve PVC për prodhimin e dyerve dhe dritareve, sipas kapitullit 39, të NKM-së, artikuj të cilët përdoren në industrinë e ndërtimit në funksion të eficiencës së energjisë;

ë) lëndët e para në forma primare për prodhimin e sfungjerëve, si dhe importimi i materialeve/artikujve, sipas kapitullit 39, të NKM-së, që përdoren në industrinë e prodhimit të mobilieve;

f) lëndët e para në forma primare me përmbajtje proteinike të forta apo materialet celuzoike, sipas kapitullit 39, të NKM-së, të cilat përdoren në industrinë e prodhimit të sallameve.

Kodet e detajuara të artikujve në kapitullin 39, të NKM-së, që përjashtohen nga taksa, sipas pikave "dh", "e", "ë" dhe "f" më sipër, përcaktohen në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.7.2019

Shpallur me dekretin nr.11243, datë 30.7.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta